

Komunikatë për media

17 tetor 2007

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit shpall rezultatet e valës 28 të privatizimit

PRISHTINË – Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) sot në ceremoninë e hapjes së ofertave të valës 28 të privatizimit, shpalli ofertuesit e përkohshëm fitues të Ndërmarrjeve të Reja të shitura përmes “Spin-ofit të rregullt”.

Gjithsej 10 Ndërmarrje të Reja kanë qenë në dispozicion. Te gjitha 10 Ndërmarrjet e Reja ishin në shitje përmes “Spin-ofit të rregullt”.

Ofertat u pranuan në zyrat qendrore të AKM-së në Prishtinë nga ora 10:00 deri në ora 12:00.

Ofertat janë hapur dhe rezultatet janë shpallur në selinë qendrore të UNMIK-ut, nga ora 13:00 deri në ora 14:00.

Gjithsej janë pranuar 40 oferta.

Vlera e tërësishme e ofertave më të larta ishte 2,876,859 €

Rezultatet dhe fituesit e dhënë më poshtë janë të përkohshëm. Agjencia Kosovare e Mirëbesimit tani është duke punuar që të përfundoj të gjitha shitjet, të cilat varen nga kontrollimi i historikut dhe përfundimi i pagesave nga ofertuesit e përkohshëm.

| Ndërmarrjet e Reja: | Ofertuesi | Çmimi |
|--|------------------|--------------|
| 1. Ndërmarrja e Re Bujqësia - Toka Bujqësore Dugajevë Sh.P.K. | P37 | 222,100€ |
| 2. Ndërmarrja e Re Bujqësia - Tokë Bujqësore Rosulë Sh.P.K. | P39 | 315,235€ |
| 3. Ndërmarrja e Re Dubrava Sh.P.K. | P20 | 1,625,616€ |
| 4. Ndërmarrja e Re 17 Nëntori Shitorja në Lypjan Sh.P.K. | P02 | 72,199€ |
| 5. Ndërmarrja e Re Fabrika e Tekstilit Letnica Sh.P.K. - | P24 | 185,000€ |
| 6. Ndërmarrja e Re Letnica Prona në Viti Sh.P.K. | P04 | 266,666€ |
| 7. Ndërmarrja e Re Kosovaelektro Administrata Sh.P.K. | P34 | 135,000€ |
| 8. Ndër.e Re Zhupa Reçan – Supermarketi në Gornje Selo Sh.P.K. | P07 | 15,013€ |
| 9. Ndërmarrja e Re Dyqanet e Çyçavicës në Vushtrri Sh.P.K. | P26 | 40,030€ |
| 10. Ndërmarrja e Re shitoret në Shtëpinë Bardhë Sh.P.K. | 0 | 0€ |